

# EDICIONI I PARË I ÇMIMEVE TË AKADEMISË "NGA FERMA NË TRYEZË"

## UDHËZIME DHE FORMULARI I APLIKIMIT

### Hyrje

Edicioni i Parë i Çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë" shënon një moment të rëndësishëm të zbatimit të projektit rajonal "Akademia nga Ferma në Tryezë për një Ballkan Perëndimor të Gjellbër – E ardhmja jonë e përbashkët evropiane", i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe që po zbatohet nga konsorciumi i Rrjeteve Kombëtare për Zhvillimin Rural në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Kroaci, si dhe platforma e tyre e bashkëpunimit rajonal, Rrjeti Ballkanik për Zhvillimin Rural (*Lexoni [broshurën e projektit](#)*).

Çmimet e Akademisë "Nga Ferma në Tryezë" do të shërbejnë si një instrument për prezantimin dhe promovimin e praktikave të mira dhe modeleve pozitive në bujqësinë e qëndrueshme, zhvillimin rural, mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e biodiversitetit, të cilat janë zbatuar nga aktorë të angazhuar në zhvillimin e qëndrueshëm rural, në veçanti nga Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC), autoritetet publike vendore si dhe institucionet e edukimit dhe ato kërkimore. Çmimet do të shërbejnë si një mjet për inkurajimin e aktorëve të ndryshëm për të ndarë historitë e tyre të suksesit, frymëzimin dhe motivimin e aktorëve të tjerë për të zbatuar praktika të qëndrueshme dhe në këtë mënyrë të kontribuojnë në tranzicionin e gjellbër dhe të drejtë në të gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

### Procesi

Çmimet e Akademisë "Nga Ferma në Tryezë" do të ndjekin një proces të strukturuar dhe gjithëpërfshirës që përfshin disa faza, të cilat prezantohen si vijon:

#### Faza 1: Njoftimi dhe dorëzimi i aplikimeve

Në fillim publikohet thirrja e hapur për aplikime, ku do të ftohen OSHC-të, fermerët, institucionet arsimore, autoritetet vendore dhe institucionet kërkimore të dërgojnë aplikimet e tyre për nisma, praktika dhe modele të zbatuara ose që janë aktualisht në proces zbatimi të cilat promovojnë zgjidhje novatore dhe të qëndrueshme për secilën kategori të çmimeve. Thirrja për aplikime do të shpërndahet përmes kanaleve të komunikimit të Rrjetit Shqiptar për Zhvillimin Rural si website, rrjetet sociale dhe email. Procesi i aplikimit dhe kriteret e vlerësimit do të shpjegohen qartësisht për të lehtësuar dorëzimin e aplikimeve.

#### Faza 2: Vlerësimi i aplikimeve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i aplikimeve të dorëzuara nga OSHC-të, fermerët, autoritetet vendore, institucionet kërkimore dhe aktorë të tjerë relevantë do të bëhet nga juria kombëtare e përbërë nga katër anëtarë. Kjo juri do të vlerësojë aplikimet në bazë të rezultateve aktuale të arritura nga



kandidatët. Vlerësimi i aplikimeve do të bazohet në kritere të përcaktuara paraprakisht, duke u fokusuar në aspekte të tilla si ndikimi i nismës në mjedis dhe biodiversitet, qëndrueshmëria, inovacioni dhe mundësia e ri-aplikimit në komunitete dhe kontekste të tjera.

Përmes një procesi të drejtë dhe transparent juria do të shqyrtojë dhe vlerësojë të gjitha aplikimet, duke zgjedhur kandidatët më të mirë në çdo kategori. Fituesit e secilës prej kategorive do të njoftohen dhe do t'ju kërkohet të përgatisin një video të shkurtër rreth dy minuta për nismën e tyre. Këto video do të ndihmojnë në prezantimin e punës së fituesve dhe do të frymëzojnë aktorët e tjerë të përfshirë në zhvillimin e qëndrueshëm të komuniteteve rurale.

### Faza 3: Dhënia e çmimeve dhe promovimi i tyre

Fituesit e çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë" do të shpallen gjatë Parlamentit të Katërt Rural Shqiptar (që organizohet një herë në dy vite). Ceremonia e ndarjes së çmimeve do të shërbejë si një platformë për të njohur dhe vlerësuar përpjekjet dhe arritjet e fituesve, si dhe për të ndarë historitë e tyre të suksesit me një audiencë të e gjerë. Fituesit do të vlerësohen me çertifikatë dhe një shpërblym simbolik financiar për të promovuar dhe zgjeruar më tej zbatimin e praktikave të qëndrueshme në nivel kombëtar.

### Kush mund të aplikojë?

Çmimet e Akademisë "Nga Ferma në Tryezë" kanë në fokus aktorët e angazhuar në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, përfshirë OSHC-të, fermerët, shoqatat e fermerëve, kooperativat, njësitë e vetëqeverisjes vendore, shkollat dhe institucionet kërkimore.

### Kriteret:

- Karakterit novator i nismës/idesë/projektit. Projekti ose ideja duhet të shkojë përtej prezantimit të praktikave tradicionale, duke përfshirë qasje novatore, metoda të reja organizative, zhvillimin i produkteve, shërbimeve ose zgjidhjeve të reja etj.
- Aspektet e qëndrueshmërisë (mjedisore, sociale dhe ekonomike) së nismës/projektit/idesë. Projekti duhet të demonstrojë qëndrueshmërinë e tij duke dhënë detaje se si lidhet me secilën prej aspekteve të qëndrueshmërisë në tre nën-seksionet përkatëse.
- Transferimi dhe ri-aplikimi i projektit/idesë në komunitete dhe kontekste të tjera lokale. Projekti duhet të demonstrojë se mund të frymëzojë dhe mund të aplikohet në zona dhe kontekste të tjera.
- Rrjetëzimi. Projekti duhet të demonstrojë vlerën e shtuar që sjellin sinergjitë, lidhjet me iniciativa të ngjashme, si dhe bashkëpunimi me aktorë dhe organizata të ndryshme. Përfshirja e të rinjve (nën 40 vjeç). Projekti duhet të demonstrojë përfshirjen e të rinjvetë zonës përkatëse si një mënyrë për të theksuar rëndësinë e tyre në bujqësinë e qëndrueshme dhe mbështetur rritjen e aftësive të tyre.

### Pse duhet të aplikoni?





Kjo është mundësia ideale për të kontribuar në rritjen e ndërgjegjësimit publik për ristrukturimin e sistemeve ushqimore, që aktualisht janë përgjegjëse për pothuajse 1/3 e emetimeve të gazrave serë në nivel botëror, përdorimin e sasive të konsiderueshme të burimeve natyrore, humbjes së biodiversitetit, ndikime negative në shëndet, si dhe nuk sigurojnë kthime të drejta ekonomike dhe mjete jetese për të gjithë aktorët, sidomos për fermerët.

A keni zhvilluar dhe zbatuar një projekt inovativ, të qëndrueshëm dhe të suksesshëm që mund të replikohet për këtë qëllim? A dëshironi ta bëni këtë projekt më të njohur për publikun?

Nëse përgjigja juaj është 'po', duhet të aplikoni në edicionin e parë të çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë", një event i integruar në Parlamentin e Katërt Rural Shqiptar. Nëse fitoni, do të merrni një shpërblim simbolik financiar për motivimin për të shtrirë zbatimin e idesë tuaj në nivel kombëtar.

### Kategoritë e Çmimeve Akademisë "Nga Ferma në Tryezë"

Kategoritë e mundshme të nominimeve për nismat, praktikat dhe modelet që kanë kontribuar në sisteme ushqimore të qëndrueshme dhe mirëqenien e komuniteteve rurale janë si vijon:

1. Bujqësia e qëndrueshme dhe zhvillimi rural
2. Mbrotjtja e mjedisit dhe ruajtja e biodiversitetit
3. Zbutja e risqeve dhe përshtatja me ndryshimet klimatike

### Përbërja e jurisë së çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë"

Juria do të përbëhet nga katër anëtarë që përfaqësojnë institucione të ndryshme, duke përfshirë:

- Një përfaqësues i nominuar nga Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural.
- Një përfaqësues i nominuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Një përfaqësues i nominuar nga Universiteti Bujqësor i Tiranës.
- Një përfaqësues nga komuniteti i fermerëve.

### Eventi i ndarjes së çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë"

Tre çmime kombëtare planifikohen të jepen në eventin e Parlamentit të Katërt Rural Shqiptar

### Afatet për procesin e aplikimit dhe dhënies së çmimeve të Akademisë "Nga Ferma në Tryezë":

Data	Përshkrimi
30 Janar 2025	Lançimi i thirrjes për aplikime
14 Mars 2025, ora 17:00	Afati i fundit për dërgimin e aplikimeve
3 Mars 2025	Krijimi i jurisë kombëtare
15 Prill 2025	Vlerësimi i aplikimeve nga juria kombëtare
1 Maj 2025	Informimi i fituesve





Funded by  
the European Union



FARM to FORK  
ACADEMY

Shtator-Tetor	Ceremonia e ndarjes së çmimeve gjatë Parlamentit të Katërt Rural Shqiptar
---------------	---

### Formulari i aplikimit

Të interesuarit për thirrjen janë të ftuar të plotësojnë formularin e aplikimit, i cili përmban seksionet e mëposhtme:

- Përshkrimi i nismës/praktikës/metodës tuaj, etj. (çfarë, kush, kur, ku)
- Përshkrimi i rëndësisë së iniciativës tuaj (pse).
- Përfitimet sociale, ekonomike dhe mjedisore nga nisma/ praktika/ metoda juaj.

Aplikimet do të pranohen vetëm përmes plotësimit të formularit online brenda datës 14 mars 2025, ora 17:00. Klikoni këtu për të plotësuar [formularin e aplikimit](#).

*\*\*\*Të dhënat tuaja personale do të mbrohen dhe nuk do të jenë të aksesueshme për palë të treta pa miratimin tuaj paraprak.*

